

Burimet: deklarata S.S, FDH-33616; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795.

Ramadan (Murtez) Berisha

(23.04.1925, shqiptar nga Lladroviqi/Ladrović, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, tre fëmijë)

Ramadani i moshëthyer me bashkëshorten Ajshen dhe fëmijët jetonin në **Lladroviq/Ladrović**. Kur më **28.07.1998**, forcat serbe e nisën bombardimin e fshatit nga drejtimi i Kleçkës/Klečka [Lipljan/Lipjan], Ramadanit me familjarët dhe vendasit i braktisën shtëpitë dhe në formë të kolonës u nisën drejt Guncatit/Guncat [Malishevë/Mališevo]. Nga ora 13:00, forcat serbe e drejtuan zjarrin e armëve ndaj kolonës, duke hedhur predhat mbi të. Një predhë ka rënë pranë këmbëve të Ramadanit, duke e lënë të vdekur në vend dhe duke i plagosur rëndë Ajshen, vëllain e Ramadanit, Avdullahun, dhe të rejën e Ramadanit. Në orët e mbrëmjes, me ndihmën e pjesëtarëve të UÇK-së, djali i Ramadanit e ka varrosur të atin në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata M.B, FDH-33471; fotografi, FDH-18858; J. Osmani, *Krimet..*, I, 534.

Latif (Ahmet) Javori

(1920, shqiptar nga Llazica/Lozica, komuna e Malishevës/Mališevo, çoban, shtatë fëmijë)

Latifi i moshuar ka qenë bari. Kur më 26.07.1998, forcat serbe nisën me bombardimin e Llazicës/Lozica, familjarët e tij u larguan nga fshati, por ai ndenji në shtëpi. Nga ajo ditë, familjarët nuk e kishin parë më kurrë dhe as nuk kishin kurrfarë njohurish për të. Pas lufte, kanë mësuar nga vendasi Zeqë Dobruna se policia serbe e kishte arrestuar atë dhe Latifin më 27.09.1998. I kishte çuar në stacionin policor të Gllgocit/Glogovac. Që të dy u liruan pas disa orësh dhe pastaj shkuan në Golluboc/Golubovac, ku e kaluan natën. Herët në mëngjes, më **28.07.1998**, Latifi u nis për në **Llazicë/Lozica** dhe ishte kjo hera e fundit që Zeqa e shihte atë të gjallë. Trupin e pajetë të Latifit e ka gjetur i biri Baliu. Kjo ka ndodhur pas lufte, më 26.06.1999, te vendi i quajtur *Rreze* në

Mëhallën Dobruna, në Llazicë/Lozica. E varrosën po atë ditë në varrezat e *Mëhallës Javori* në Llazicë/Lozica.

Burimet: deklarata H.J, FDH-15988; deklarata H.J, FDH-33618; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 155, FDH-23857; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242.

Sherif (Miftar) Kryeziu

(13.08.1959, shqiptar nga Mleqani/Mlečane, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, tre fëmijë)

Forcat serbe e bombarduan Mleqanin/Mlečane më 26.06.1998. Po atë ditë, popullata shqiptare e ka braktisur fshatin. Sherifi nuk lëvizi nga shtëpia e vet. Para së të binte terri i natës, djemtë e vëllait të Sherifit, Izeti dhe Edmondi, me kushëririn Baftijarin u kthyen në fshat. Të gjithë e kaluan natën në bodrumin e Sherifit. Të nesërmen, shkuan në Golluboc/Golubovac dhe u strehuan në mëhallën *Lagja e Madhe/Veliko naselje*. Një ditë më vonë, më **28.07.1998**, rreth orës 12:00, Sherifi vendosi të kthehej në Mleqan/Mlečane, që ta merrte bagëtinë dhe, më pas, planifikonte t'i bashkëngjitej familjes, e cila gjendej në pyll përmbi fshatin e Negrocit/Negrovce [Gllgoc/Glogovac]. Izeti, Baftijari dhe Edmondi shkuan në pyll dhe nga vendi i quajtur *Bajkovë* kishin mundësi të observonin çfarë po ndodhte në fshat [**Mleqan/Mlečane**]. I shihnin policët dhe ushtarët serbe duke lëvizur nëpër fshat, si dhe Sherifin në oborrin e tij. Kur ushtarët dhe policët filluan tu vënin flakën shtëpive të fshatit, të afërmit e Sherifit u larguan nga pozicioni dhe nuk panë çfarë kishte ndodhur me Sherifin. Familjarët e tij u kthyen në fshat në muajin tetor të vitit 1998, por nuk e gjetën asnjë gjurmë të Sherifit. Në muajin dhjetor të vitit 1998, trupi i Sherifit është gjetur në bunar, në oborrin e tij. Duart dhe këmbët i kishte të lidhura, ndërkaq në trup i vëreheshin shumë prera thike. E varrosën në varrezat në *Mëhallën Gashi* në Mleqan/Mlečane.

Burimet: deklarata I.K, FDH-16583; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242.
